

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 34

## Raportimi Financiar i Ndërmjetëm

### Objektivi

---

Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë përmbajtjen minimale të një raporti financiar të ndërmjetëm dhe të përshkruajë parimet që përdoren për njohjen dhe matjen në pasqyrat financiare të plota ose të kondensuara për një periudhë të ndërmjetme. Raportimi financiar i ndërmjetëm, i dhënë në kohë dhe me besueshmëri, ju jep mundësi investitorëve, kreditorëve dhe të tjerëve të kuptojnë aftësinë e një njësie ekonomike për të gjeneruar të ardhura dhe kushtet financiare e likuiditetin e saj.

### Objekti

---

- 1 Ky Standard nuk tregon se cilat njësi ekonomike duhet të kërkohet të publikojnë raporte financiare të ndërmjetme, sa shpesh, apo pas sa kohe pas fundit të periudhës së ndërmjetme. Megjithatë, qeveritë, rregullatorët e letrave me vlerë, bursat dhe organizmat kontabël shpesh u kërkojnë njësive ekonomike, letrat me vlerë të borxhit ose kapitalit neto të të cilave tregtohen publikisht, të publikojnë raporte financiare të ndërmjetme. Ky Standard zbatohet në qoftë se një njësi ekonomike kërkohet ose zgjedh të publikojë një raport financiar të ndërmjetëm në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit inkurajon njësitë ekonomike letrat me vlerë të të cilave tregtohen publikisht, të të japin raporte financiare të ndërmjetme, që janë në pajtim me parimet e njohjes, matjes dhe të dhënies së informacioneve shpjeguese, të parashtruara në këtë Standard. Në mënyrë të vecantë, njësitë ekonomike, letrat me vlerë të të cilave tregtohen publikisht, inkurajohen:
  - (a) të japin raporte financiare të ndërmjetme, të paktën në fund të gjysmës së parë të vitit financiar të tyre; dhe
  - (b) t'i bëjnë të disponueshme raportet e tyre financiare të ndërmjetme jo më vonë se 60 ditë pas fundit të periudhës së ndërmjetme.
- 2 Cdo raport financiar, vjetor apo i ndërmjetëm, vlerësohet në mënyrë të pavarur për pajtueshmërinë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Fakti që një njësi mund të mos ketë dhënë raporte financiare të ndërmjetme gjatë një viti të caktuar financiar ose mund të ketë dhënë raporte financiare të ndërmjetme, të cilët nuk janë në pajtim me kërkesat e këtij Standardi, nuk përbën pengesë që pasqyrat financiare vjetore të njësisë ekonomike të jenë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- 3 Në qoftë se një raport financiar i ndërmjetëm i njësisë ekonomike është përshkruar se është në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, ai duhet të jetë në pajtim me të gjitha kërkesat e këtij Standardi. Paragrafi 19 kërkon që, në lidhje me këtë, të jepen disa informacione shpjeguese.

### Përkufizime

---

- 4 **Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:**

*Periudha e ndërmjetme* është një periudhë e raportimit financiar më e shkurtër se një vit financiar i plotë.

*Raport Financiar i Ndërmjetëm* do të thotë një raport financiar që përmban ose një paketë të plotë të pasqyrave financiare (sikurse përshkruhen në SNK 1 “Paraqitja e Pasurave Financiare”) ose

---

<sup>1</sup> Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është zëvendësuar me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, që filloi aktivitetin në vitin 2001

një paketë të pasqyrave financiare të kondensuara (sikurse përshkruhen në këtë Standard) për një periudhë të ndërmjetme.

## **Përmbajtja e një raporti financiar të ndërmjetëm**

---

- 5 SNK 1 e përcakton një paketë të plotë të pasqyrave financiare, me përfshirjen e komponentëve të mëposhtëm:
- (a) një bilanc;
  - (b) një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve;
  - (c) një pasqyrë e ndryshimeve në kapital, ku tregohen,
    - (i) të gjitha ndryshimet në kapitalin neto, ose
    - (ii) ndryshimet në kapitalin neto, të cilat nuk kanë ardhur nga transaksionet me zotëruesit e kapitalit neto të kryera nga pozita e tyre si të tillë;
  - (d) një pasqyrë e fluksit të mjeteve monetare; dhe
  - (e) shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese.
- 6 Në interes të paraqitjes në kohë dhe me pak kosto dhe, për të shmangur përsëritjen e informacioneve të raportuara më parë, një njësi ekonomike mund të kërkohet ose mund të zgjedhë vetë të japë më pak informacion në datat e ndërmjetme, në krahasim me pasqyrat financiare vjetore të saj. Ky Standard përcakton përmbajtjen minimale të një raporti financiar të ndërmjetëm, në të cilën përfshihen pasqyrat financiare të kondensuara dhe shënimet shpjeguese të përzgjedhura. Raporti financiar i ndërmjetëm parashikohet të japë një përditësim më të fundit të paketës së plotë të pasqyrave financiare vjetore. Prandaj, ai fokusohet në aktivitetet, ngjarjet dhe rrethanat e reja dhe nuk përsërit informacionin e raportuar më parë.
- 7 Asgjë në këtë Standard nuk ka për synim të ndalojë apo pengojë një njësi ekonomike që ajo të publikojë një paketë të plotë të pasqyrave financiare (siç përshkruhen në SNK 1) në raportin financiar të ndërmjetëm të saj, në vend të pasqyrave financiare të kondensuara dhe shënimeve shpjeguese të përzgjedhura. Ky Standard as nuk ndalon dhe as pengon një njësi ekonomike që ajo të përfshijë në pasqyrat financiare të kondensuara më shumë se minimumi i zërave apo shënimeve shpjeguese të përzgjedhura, të paraqitura në këtë Standard. Udhëzimi për njohjen dhe matjen që jepet në këtë Standard zbatohet edhe për pasqyrat financiare të plota për një periudhë të ndërmjetme, dhe këto pasqyra do të duhej të përfshinin të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara nga ky Standard (e vecanërisht dhënien e informacioneve shpjeguese për shënimet e përzgjedhura, të parashikuara në Paragrafin 16) si edhe ato që kërkohen nga Standardet e tjera.

## **Përbërësit minimalë të një raporti financiar të ndërmjetëm**

- 8 **Raporti financiar i ndërmjetëm përmban, minimalisht, përbërësit e mëposhtëm:**
- (a) **një bilanc të kondensuar;**
  - (b) **një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve të kondensuar;**
  - (c) **një pasqyrë të kondensuar ku tregohen ose (i) të gjitha ndryshimet në kapitalin neto ose (ii) ndryshimet në kapitalin neto, me përjashtim të atyre ndryshimeve që vijnë nga transaksionet e kapitalit me pronarët dhe shpërndarjet për pronarët;**
  - (d) **një pasqyrë e flukseve të mjeteve monetare të kondensuar; dhe**
  - (e) **shënimet shpjeguese të përzgjedhura.**

## Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të ndërmjetme

- 9 Në qoftë se një njësi ekonomike publikon një paketë të plotë të pasqyrave financiare në raportin financiar të ndërmjetëm të saj, forma dhe përmbajtja e këtyre pasqyrave duhet të jetë në pajtim me kërkesat e SNK 1 për një paketë të plotë të pasqyrave financiare.
- 10 Në qoftë se një njësi ekonomike publikon një paketë të plotë të pasqyrave financiare të kondensuara në raportin financiar të ndërmjetëm të saj, këto pasqyra të kondensuara duhet të përfshijnë minimalisht të gjithë titujt dhe nëntitujt me shumat përkatëse, të cilat kanë qenë të përfshira në pasqyrat financiare vjetore më të fundit dhe shënimet shpjeguese të përzgjedhura siç kërkohet nga ky Standard. Zëra ose shënime të tjera shtesë do të përfshihen po qe se mungesa e tyre do të bënte që pasqyrat financiare të ndërmjetme të kondensuara, të ishin corientuese.
- 11 Fitimet për aksion bazë dhe të pakësuara duhet të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, e plotë apo e kondensuar qoftë kjo, për një periudhë të ndërmjetme.
- 12 SNK 1 jep udhëzime për strukturën e pasqyrave financiare. Udhëzimi për Zbatimin e SNK 1 ilustron mënyrat në të cilat mund të paraqitet bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyrave e ndryshimeve në kapital.
- 13 SNK 1 kërkon që pasqyra e ndryshimeve në kapital të paraqitet si një pjesë përbërëse e vecantë e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike dhe lejon që informacioni për ndryshimet në kapital, të cilat vijnë nga transaksionet me zotëruesit e kapitalit (përfshirë shpërndarjet për zotëruesit e kapitalit) të tregohet ose në pasqyrë ose në shënime. Një njësi ekonomike përdor të njëjtin format në pasqyrën e saj të ndërmjetme të ndryshimeve në kapital, të cilin ajo e ka përdorur në pasqyrën vjetore më të fundit.
- 14 Raporti financiar i ndërmjetëm përgatitet mbi një bazë konsoliduar po qe se shumica e pasqyrave financiare vjetore më të fundit të njësisë ekonomike kanë qenë pasqyra të konsoliduara. Pasqyrat financiare të veçanta të shoqërisë mëmë nuk janë në koherencë ose të krahasueshme me pasqyrat e konsoliduara në raportin financiar vjetor më të fundit. Në qoftë se raporti financiar vjetor i një njësie ekonomike ka përfshirë pasqyrat financiare të veçanta të shoqërisë mëmë, krahas pasqyrave financiare të konsoliduara, ky Standard as kërkon e as ndalon përfshirjen e pasqyrave financiare të veçanta të shoqërisë mëmë në raportin financiar të ndërmjetëm të njësisë ekonomike.

## Shënimet shpjeguese të përzgjedhura

- 15 Një përdorues i raportit financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike duhet të ketë akses edhe në raportin financiar vjetor më të fundit të asaj njësie ekonomike. Prandaj, është e panevojshme që shënimet e raportit financiar të ndërmjetëm të japin përditësime të informacioneve relativisht të parëndësishme, të cilat kanë qenë raportuar në shënimet e raportit vjetor më të fundit. Në një datë të ndërmjetme, ka më shumë dobi të jepet një shpjegim i ngjarjeve dhe i transaksioneve që janë të rëndësishme për të kuptuar ndryshimet që kanë ndodhur në pozicionin financiar dhe performancën e njësisë ekonomike që nga data të raportimit vjetor më të fundit.
- 16 Një njësi ekonomike duhet të përfshijë, minimalisht, informacionin e mëposhtëm, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të ndërmjetme të saj, në qoftë se ai është material dhe po qe se nuk është paraqitur tjetërkund në raportin financiar të ndërmjetëm. Normalisht, informacioni duhet të raportohet mbi një bazë financiare progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit. Megjithatë, njësi ekonomike duhet të japë shpjegime edhe për çdo ngjarje apo për transaksione, të cilat janë materiale për të kuptuar periudhën e ndërmjetme aktuale:
- (a) një deklaratë që tregon se janë ndjekur të njëjtat politika kontabël dhe metoda të përlllogaritjes si për pasqyrat financiare të ndërmjetme ashtu edhe për pasqyrat financiare vjetore më të fundit, ose, nëse këto politika apo metoda kanë ndryshuar, një përshkrim të natyrës dhe efektit të ndryshimit;
  - (b) komente shpjeguese për sezonalitetin ose karakterin ciklik të operacioneve të ndërmjetme;
  - (c) natyrën dhe shumën e zërave që kanë ndikim në aktivet, pasivet, kapitalin neto, të ardhurat neto, ose flukset e mjeteve monetare, të cilat janë të pazakonshme për shkak të natyrës, madhësisë, ose rastësisë;

- (d) natyrën dhe shumën e ndryshimeve në çmuarjet e shumave të raportuara në periudhat e mëparshme të vitit financiar aktual ose të ndryshimeve në çmuarjet e shumave të raportuara në vitet financiare të mëparshme, në qoftë se këto ndryshime kanë një efekt material në periudhën aktuale të ndërmjetme;
- (e) emetimet, riblerjet dhe shlyerjet e letrave me vlerë të borxhit dhe të kapitalit të vet;
- (f) dividendët e paguar (të agreguar ose për aksion) veças për aksionet e zakonshme dhe për aksionet e tjera;
- (g) informacionin e mëposhtëm për segmentet (dhënia e informacionit shpjegues për segmentet kërkohet në raportin financiar të ndërmjetëm të njësisë ekonomike vetëm në qoftë se SNRF 8 *Segmentet e Shfrytëzimit* kërkon që njësia ekonomike të japë, në pasqyrat financiare vjetore të saj, informacion shpjegues për segmentin):
  - (i) të ardhurat nga klientët e jashtëm, në qoftë se janë përfshirë në matjen e fitimit ose humbjes të segmentit, të rishikuara nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ, ose ndryshe të paraqitura rregullisht tek shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ;
  - (ii) të ardhurat ndërsegmentare, po qe se ato janë përfshirë në matjen e fitimit ose humbjes të segmentit, të rishikuara nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ, ose ndryshe të paraqitura rregullisht tek shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ;
  - (iii) një matje të fitimit ose humbjes të segmentit;
  - (iv) aktivet gjithsej për të cilat ka patur një ndryshim material nga shuma e paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të fundit;
  - (v) një përshkrim i diferencave nga pasqyrat financiare vjetore të fundit, në bazë të segmentimit ose në bazë të matjes së fitimit ose humbjes të segmentit;
  - (vi) një rakordim të shumës gjithsej të matjeve të fitimit ose humbjes të segmenteve që raportojnë, me fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike para shpenzimit tatimor (të ardhurat tatimore) dhe operacioneve jo të vijueshme. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike u cakton segmenteve që raportojnë zëra të tilla si shpenzimi tatimor (të ardhurat tatimore), njësia ekonomike mund të rakordojë totalin e matjeve të fitimit ose të humbjes të segmenteve me humbjen ose fitimin e pas këtyre zërave. Zërat e rakorduar, që janë materiale identifikohen dhe përshkruhen veças në këtë rakordim;
- (h) ngjarjet materiale që kanë ndodhur pas mbylljes së periudhës së ndërmjetme, të cilat nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare të periudhës së ndërmjetme;
- (i) efektin e ndryshimeve në përbërjen e njësisë ekonomike gjatë periudhës së ndërmjetme, përfshirë kombinimet e biznesit, blerjen apo likuidimin e filialeve dhe të investimeve afatgjata, ristrukturimet dhe operacionet jo të vijueshme. Në rastin e kombinimeve të biznesit, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar sipas paragrafëve 66-73 të SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*; dhe
- (j) ndryshimet në pasivet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara që nga data e bilancit vjetor të fundit.

17 Më poshtë jepen shembuj të këtyre informacioneve shpjeguese të cilat kërkohen nga paragrafi 16. Për shumë prej tyre japin udhëzime Standardet dhe Interpretimet Individuale:

- (a) zhvlerësimi i inventarëve në vlerën neto të realizueshme dhe anulimi i këtyre zhvlerësimeve;
- (b) njohja e një humbjeje nga zhvlerësimi i aktiveve materiale afatgjata - ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, i aktiveve jo-materiale ose aktiveve të tjera, dhe anulimi i kësaj humbjeje nga zhvlerësimi;
- (c) anulimi i provizioneve për kostot e ristrukturimit;
- (d) blerja dhe shitja e zërave të aktiveve afatgjata materiale - toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje;
- (e) angazhimet për blerjen e aktiveve materiale afatgjata - toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje;

- (f) zgjidhjet e çështjeve gjyqësore;
  - (g) ndreqjet e gabimeve të periudhave të mëparshme;
  - (h) [Fshirë]
  - (i) mos-shlyerja e huave në kohë ose shkelja e një marrëveshje huaje, e cila nuk është ndrequr përpara datës së bilancit; dhe
  - (j) transaksionet me palët e lidhura.
- 18 Standardet e tjera specifikojnë dhëniet e informacione shpjeguese që duhet të bëhen në pasqyrat financiare. Në këtë kontekst, pasqyrat financiare kane kuptimin e një pakete të plotë të pasqyrave financiare të llojit që normalisht përfshihet në një raport financiar vjetor dhe shpeshherë edhe në raporte të tjera. Përveç asaj që kërkohet nga paragrafi 16(i), dhëniet e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardet e tjera nuk kërkohen, në qoftë se raporti financiar i ndërmjetëm i një njësie ekonomike përfshin vetëm pasqyrat financiare të kondensuara dhe shënimet shpjeguese të përzgjedhura, dhe jo një paketë të plotë të pasqyrave financiare.

## **Dhënia e informacioneve shpjeguese për pajtueshmërinë me SNRF-të**

- 19 Në qoftë se raporti financiar i ndërmjetëm i një njësie ekonomike është në pajtim me kërkesat e këtij Standardi, për këtë fakt duhet të jepen informacione shpjeguese. Një raport financiar i ndërmjetëm nuk duhet të përshkruhet se është në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, po qe se ai nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## **Periudhat për të cilat kërkohet të paraqiten pasqyrat financiare të ndërmjetme**

- 20 Raportet e ndërmjetme duhet të përfshijnë pasqyrat financiare të ndërmjetme (të kondensuara ose të plota) për periudhat si më poshtë:
- (a) bilancin e mbylljes të periudhës së ndërmjetme aktuale dhe një bilanc krahasues të mbylljes të vitit financiar paraardhës;
  - (b) pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e ndërmjetme aktuale dhe progresive për vitin financiar aktual deri në datën e raportimit, me pasqyrat krahasuese të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhat e ndërmjetme të krahasueshme (aktuale dhe progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit) të vitit financiar paraardhës;
  - (c) pasqyrën që tregon ndryshimet në kapital progresive për vitin financiar aktual deri në datën e raportimit, me një pasqyrë krahasuese për periudhën e krahasueshme nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit financiar të vitit financiar paraardhës më të fundit; dhe
  - (d) pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin financiar aktual deri në datën e raportimit, me një pasqyrë krahasuese për periudhën e krahasueshme progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit financiar të vitit financiar paraardhës më të fundit;
- 21 Për një njësi ekonomike, aktiviteti tregtar i të cilës është tepër sezonal, mund të jenë të dobishëm informacionet financiare për dymbëdhjetë muaj të cilët mbyllen në datën e raportimit të ndërmjetëm dhe informacionet krahasuese për periudhën e mëparshme dymbëdhjetëmujore. Prandaj, njësitë ekonomike, aktiviteti tregtar i të cilave është tepër sezonal, inkurajohen që të mbajnë parasysh raportimin e këtij informacioni krahas informacionit që kërkohet në paragrafin paraardhës.
- 22 Shtojca A ilustron periudhat që kërkohet të paraqiten nga një njësi ekonomike e cila raporton çdo gjashtëmujor dhe nga një njësi ekonomike e cila raporton çdo tremujor.

## Materialiteti

- 23 Për të përcaktuar mënyrën si të njihet, klasifikohet apo të shpjegohet një zë për qëllime të raportimit financiar të ndërmjetëm, duhet të vlerësohet materialiteti në lidhje me të dhënat financiare të periudhës së ndërmjetme. Në vlerësimet e materialitetit, duhet të pranohet që matjet e ndërmjetme mund të mbështeten në çmuarje në një shkallë më të madhe se sa matjet e të dhënave financiare vjetore.
- 24 SNK 1 dhe SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Çmuarjet Kontabël dhe Gabimet* e përkufizojnë një zë si material në qoftë se mungesa ose keq-paraqitja e tij do të influenconte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. SNK 1 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese të vecanta për zërat materiale, duke përfshirë (për shembull) operacionet jo të vijueshme, dhe SNK 8 kërkon dhënien e informacioneve për ndryshimet në çmuarjet kontabël, gabimet dhe ndryshimet në politikat kontabël. Të dy Standardet nuk përmbajnë udhëzime të natyrës sasiore për sa i përket materialitetit.
- 25 Ndonëse për vlerësimin e materialitetit gjithmonë kërkohet gjykimi, ky Standard e bazon vendimin për njohjen dhe dhënien e informacioneve mbi të dhënat për periudhën e ndërmjetme vetvetiu, për arsye të kuptueshmërisë së shifrave të ndërmjetme. ose çmuarjet dhe gabimet, njihen dhe paraqiten në bazë të materialitetit në lidhje me të dhënat e periudhës së ndërmjetme për të shmangur ndonjë konkluzion keq-udhëzues, që mund të rrjedhë nga mosdhënia e informacionit. Qëllimi kryesor është të merret siguria se një raport financiar i ndërmjetëm përfshin të gjithë informacionin i cili është i përshtatshëm për të kuptuar pozicionin financiar dhe performancën e një njësie ekonomike gjatë periudhës së ndërmjetme.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare vjetore

- 26 Në qoftë se një çmuarje e një shume, të raportuar në një periudhë të ndërmjetme, ndryshon ndjeshëm gjatë periudhës të ndërmjetme të fundit të vitit financiar, dhe për këtë periudhë të ndërmjetme mbyllëse nuk është publikuar ndonjë raport financiar i veçantë, në një shënim të pasqyrave financiare vjetore të atij viti financiar duhet të shpjegohen natyra dhe shuma e këtij ndryshimi në çmuarje.
- 27 SNK 8 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për natyrën dhe (në qoftë se është e mundur) për shumën e ndryshimit në çmuarje, i cili ose ka një efekt material në periudhën aktuale ose pritet të ketë një efekt material në periudhat pasuese. Paragrafi 16(d) i këtij Standardi kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese të ngjashme në një raport financiar të ndërmjetëm. Shembujt përfshijnë ndryshimet në çmuarje në periudhën e fundit të ndërmjetme, që kanë të bëjnë me zhvlerësimet e inventarit, ristrukturimet, ose humbjet nga zhvlerësimi, të cilat kanë qënë raportuar në një periudhë të ndërmjetme më të hershme të po atij viti financiar. Dhënia e informacioneve shpjeguese që kërkohen nga paragrafi paraardhës është në koherencë me kërkesat e SNK 8 dhe është parashikuar të jetë e ngushtë në objekt, duke u lidhur vetëm me ndryshimin në çmuarje. Një njësi ekonomike nuk kërkohet të përfshijë në pasqyrat financiare vjetore informacion financiar shtesë për periudhën e ndërmjetme.

## Njohja dhe matja

### Të njëjtat politika kontabël si edhe ato vjetore

- 28 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë, për pasqyrat financiare të ndërmjetme, po ato politika kontabël të cilat i ka zbatuar në pasqyrat financiare vjetore, me përjashtim të rasteve kur në politikat kontabël janë bërë ndryshime pas datës së pasqyrave financiare vjetore më të fundit, të cilat do të reflektohen në pasqyrat financiare vjetore të radhës. Megjithatë, shpeshësia e raportimit të një njësie ekonomike (vjetore, gjashtëmujore apo tremujore) nuk ndikon në matjen e rezultateve të saj vjetore. Për të arritur këtë objektiv, matjet për qëllime të raportimit të ndërmjetëm, duhet të bëhen mbi bazë progresive që nga fillimi i vitit e deri në datën e raportimit.
- 29 Të kërkojë që një njësi ekonomike të zbatojë të njëjtat politika kontabël në pasqyrat financiare të ndërmjetme, të cilat ajo i ka zbatuar edhe në pasqyrat vjetore mund të duket sikur nënkupton se matjet e periudhës së ndërmjetme bëhen sikur këto periudha të ndërmjetme të qëndrojnë më vete, si të ishin një

periudhë e pavarur raportimi. Megjithatë, nisur nga fakti që shpeshësia e raportimit të një njësie ekonomike nuk do të ndikojë në matjen e rezultateve të saj vjetore, paragrafi 28 pranon se një periudhë e ndërmjetme është një pjesë një viti financiar të gjatë. Matjet progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit mund të përfshijnë ndryshime në çmuarjet e shumave të raportuara në periudhat e ndërmjetme të vitit financiar aktual. Por parimet për njohjen e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhat e ndërmjetme janë po ato që zbatohen edhe për pasqyrat financiare vjetore.

30 Për ta ilustruar:

- (a) parimet për njohjen dhe matjen e humbjeve nga zhvlerësimet e inventarit, ristrukturimet ose zhvlerësimet në një periudhë të ndërmjetme janë njëlloj me ato që një njësi ekonomike do të kishte ndjekur në qoftë se ajo do të përgatiste vetëm pasqyra financiare vjetore. Megjithatë, në qoftë se këto zëra janë njohur e matur në një periudhë të ndërmjetme dhe ndryshimet e çmuarjeve në periudhën e ndërmjetme pasuese të atij viti financiar, çmuarja fillestare ndryshohet në periudhën e ndërmjetme pasuese ose përmes konstatimit të një shume shtesë të humbjes ose përmes anulimit të shumës së njohur më parë;
- (b) një kosto që nuk përmbush kërkesën e përkufizimit të një aktivi në fund të periudhës së ndërmjetme, nuk shtyhet në kohë në bilanc, as për të pritur një informacion të ardhshëm përsa i përket faktit nëse ajo ka përmbushur kërkesën e përkufizimit të një aktivi, as edhe për të zbutur fitimet gjatë periudhave të ndërmjetme brenda një viti financiar; dhe
- (c) shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat njihen në çdo periudhë të ndërmjetme bazuar në çmuarjen më të mirë të bërë për shkallën tatimore mesatare vjetore të tatimit mbi të ardhurat, të parashikuara për të gjithë vitin financiar. Shumat e konstatuara për shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat në një periudhë të ndërmjetme mund të duhet të rregullohen në një periudhë të ndërmjetme pasuese të po atij viti financiar, në qoftë se ndryshon çmuarja e shkallës së tatimit vjetor mbi të ardhurat.

31 Sipas *Kuadrit për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare (Kuadri)* njohja është “procesi i përfshirjes në bilanc ose në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të një zëri i cili përmbush përkufizimin e një elementi dhe kënaq kriterin e njohjes”. Përkufizimet e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve janë themelore për njohjen, si në datën e raportimit financiar vjetor ashtu edhe në datën e raportimit financiar të ndërmjetëm.

32 Për aktivet, zbatohen të njëjtat teste të përfitimeve ekonomike të ardhshme në datat e ndërmjetme dhe në mbyllje të vitit financiar të një njësie ekonomike. Kostot të cilat, nga natyra e tyre, nuk do të kualifikohen si aktive në mbyllje të vitit financiar, nuk do të kualifikohen si të tilla as në datat e ndërmjetme. Po kështu, një pasiv në datën e raportimit financiar të ndërmjetëm, duhet të përfaqësojë një detyrim ekzistues në atë datë, njësoj siç do të duhej të përfaqësonte në datën e raportimit vjetor.

33 Një karakteristikë thelbësore e të ardhurave dhe shpenzimeve është se duhet të kenë ndodhur flukset hyrëse dhe dalëse përkatëse të aktiveve dhe pasiveve. Kur këto flukse hyrëse dhe dalëse të kenë ndodhur do të njihen edhe të ardhurat e shpenzimet përkatëse; përndryshe, ato nuk njihen. *Kuadri* thotë se “shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ka ndodhur një pakësim i përfitimeve ekonomike të ardhshme që lidhen me një pakësim në një aktiv ose një rritje të një pasivi, i cili mund të matet me besueshmëri ... *Kuadri* nuk lejon njohjen në bilanc të zërave, të cilët nuk përmbushin përkufizimin e aktiveve ose të pasiveve.”

34 Për matjen e aktiveve, pasiveve, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve të mjeteve monetare të raportuara në pasqyrat financiare, njësia ekonomike e cila raporton vetëm një herë në vit është në gjendje të marrë në konsideratë informacionet që bëhen të mundëshme gjatë gjithë vitit financiar. Në të vërtetë, matjet e saj janë mbi bazë progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit.

35 Një njësi ekonomike që raporton çdo gjashtëmujor, përdor informacionet të cilat janë të gatëshme nga mesi ose diçka më pas se mesi i vitit, kur ajo bën matjet në pasqyrat financiare të periudhës së gjashtëmujorit të parë, dhe informacionin që është i gatshëm në mbyllje ose diçka më pas se mbyllja e vitit, për periudhën 12 mujore. Matjet dymbëdhjetëmujore do të reflektojnë ndryshimet e mundshme në çmuarjet e shumave të raportuara për periudhën e gjashtëmujorit të parë. Shumat e raportuara në raportin financiar të ndërmjetëm për gjashtëmujorin e parë nuk rregullohen në mënyrë prapavepruese. Megjithatë, paragrafët 16(d) dhe 26 kërkojnë që të jepen informacione shpjeguese për natyrën dhe shumën e çdo ndryshimi të rëndësishëm në çmuarjet e bëra.

- 36 Një njësi ekonomike që raporton më shpesh se çdo gjashtëmuor i mat të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit për çdo periudhë të ndërmjetme duke përdorur informacionin që ka në dispozicion në kohën kur përgatitet çdo paketë e pasqyrave financiare. Shumat e të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara në periudhën e ndërmjetme aktuale do të reflektojnë të gjitha ndryshimet në çmuarjet e shumave të raportuara në periudhat e ndërmjetme të mëparshme të vitit financiar. Shumat e raportuara në periudhat e ndërmjetme të mëparshme nuk rregullohen në mënyrë prapavepruese. Megjithatë, paragrafët 16(d) dhe 26 kërkojnë që të jepen informacione shpjeguese për natyrën dhe shumën e çdo ndryshimi të rëndësishëm në çmuarjet e bëra.

## **Të ardhurat e arkëtuara në mënyrë sezonale, ciklike ose me raste**

- 37 **Të ardhurat, të cilat arkëtohen në mënyrë sezonale, ciklike ose me raste brenda një viti financiar, nuk duhet të parashikohen ose shtyhen në një datë të ndërmjetme, po qe se parashikimi ose shtyrja në kohë nuk do të ishin të përshtatshme në mbyllje të vitit financiar të njësisë ekonomike.**
- 38 Si shembuj mund të përmenden të ardhurat nga dividendi, të ardhurat nga e drejta e pronësisë dhe grantet qeveritare. Vec kësaj, disa njësi ekonomike fitojnë rregullisht më shumë të ardhura në disa periudha të caktuara të ndërmjetme të një viti financiar, se në periudhat e ndërmjetme të tjera, si për shembull, të ardhurat sezonale të shitësve me pakicë. Këto të ardhura njihen atëherë kur ato ndodhin.

## **Kostot që gjatë vitit financiar kryhen në mënyrë të parregullt**

- 39 **Kostot, të cilat gjatë vitit financiar të një njësie ekonomike, janë kryer në mënyrë të parregullt, duhet të parashikohen ose shtyhen në kohë për qëllime të raportimit të ndërmjetëm, në qoftë se dhe vetëm në qoftë se, është gjithashtu, e përshtatshme qe kjo lloj kostoje, të parashikohet ose të shtyhet në kohë në mbyllje të vitit financiar.**

## **Zbatimi i parimeve të njohjes dhe matjes**

- 40 Shtojca B jep shembuj të zbatimit të parimeve të përgjithshme të njohjes dhe matjes të cilat janë parashtruar në paragrafët 28-39.

## **Përdorimi i çmuarjeve**

- 41 **Procedurat e matjes, që duhet ndiqen në një raport financiar të ndërmjetëm, duhet të hartohen për të siguruar që informacioni që rezulton është i besueshëm dhe se i gjithë informacioni financiar material, i cili është i përshtatshëm për të kuptuar pozicionin apo performancën financiare të njësisë ekonomike, është shpjeguar në mënyrën e duhur. Ndonëse matjet qoftë në raportet financiare vjetore, ashtu edhe ato të ndërmjetëm shpesh bazohen në çmuarje të arsyeshme, përgatitja e raporteve financiare të ndërmjetme në përgjithësi do të kërkojë një përdorim më të madh të metodave të çmuarjes karahasuar me raportet financiare vjetore.**
- 42 Shtojca C jep shembuj të përdorimit të çmuarjeve në periudhat e ndërmjetme.

## **Riparaqitja e periudhave të ndërmjetme të raportuara më parë**

---

- 43 **Një ndryshim në politikën kontabël, ndryshe nga një ndryshim për të cilën kalimi është specifikuar nga një Standard ose Interpretim i ri, duhet të reflektohet nëpërmjet:**
- (a) **riparaqitjes së pasqyrave financiare të periudhave të ndërmjetme të mëparshme të vitit financiar aktual dhe të periudhave të ndërmjetme të krahasueshme të viteve financiare të mëparshme, të cilat do të riparaqiten në pasqyrat financiare vjetore në përputhje me SNK 8; ose**



**(b) kur nuk është praktikisht e mundur, përcaktimit të efekti progresiv, në fillim të vitit financiar, të zbatimit të një politike të re kontabël për të gjitha periudhat e mëparshme, duke rregulluar pasqyrat financiare të periudhave të ndërmjetme të mëparshme të vitit financiar aktual dhe periudhat e ndërmjetme të krahasueshme të viteve financiare të mëparshme, për të zbatuar politikën e re kontabël në mënyrë pasvepruese që nga data më e hershme praktikisht e mundshme.**

- 44 Një objektivi i parimit të mësipërm është të sigurohet që gjatë gjithë vitit financiar të zbatohet një politikë e vetme kontabël për një klasë të veçantë transaksionesh. Sipas SNK 8, një ndryshim në politikën kontabël reflektohet përmes zbatimit prapaveprues, me një riparaqitje të të dhënave financiare të periudhës së mëparshme, sa më larg që të jetë e mundur, prapa në kohë. Megjithatë, në qoftë se shuma kumulative e rregullimit që ka të bëjë me vitet financiare të mëparshme nuk është praktikisht e mundur të përcaktohet, atëherë sipas SNK 8 politika e re duhet të zbatohet në mënyrë pasvepruese që nga data më e hershme praktikisht e mundshme. Efekti i parimit që jepet në paragrafin 43 është të kërkojë që brenda vitit financiar çdo ndryshim në politikën kontabël të zbatohet ose në mënyrë prapavepruese ose, kur kjo nuk është e mundur, në mënyrë pasvepruese, duke filluar jo më vonë se fillimi i vitit financiar.
- 45 Për të lejuar që ndryshimet kontabël të jenë të reflektuara në datën e ndërmjetme brenda vitit financiar, do të duhej që, brenda një viti financiar të vetëm, për një klasë të veçantë të transaksioneve, të lejohej të zbatoheshin dy politika kontabël të ndryshme. Rezultat i kësaj do të ishin vështirësitë e shpërndarjes së ndërmjetme, rezultatet e shfrytëzimit të fshehura, dhe analiza e kuptueshmëri e komplikuar për informacionin e periudhës së ndërmjetme.

## **Data e hyrjes në fuqi**

---

- 46 **Ky Standard bëhet operativ për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 janar 1999 ose më pas. Inkurajohet zbatimi më i hershëm.**